

NORMALIZIMI I MARRËDHËNIEVE KOSOVË-SERBI

KËNDVËSHTRIMI I QYTETARËVE



SHKURT 2018

NORMALIZIMI I MARRËDHËNIEVE KOSOVË-SERBI

KËNDVËSHTRIMI I QYTETARËVE



SHKURT 2018

COPYRIGHT © 2018. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,
10 000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Ueb: www.kdi-kosova.org

Vërejtje: Ky raport është rezultat i një hulumtimi që është realizuar në kuadër të projektit "Forcimi i mbikëqyrjes parlamentare të ekzekutivit dhe rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në dialogun Kosovë-Serbi", i financuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës, dhe në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohet që reflekton qëndrimet e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës.

PËRMBAJTJA

06

HYRJE

07

METODOLOGJIA

08

REZULTATET E HULUMTIMIT TË OPINIONIT PUBLIK

10

PYETJET E SONDAZHIT

12

1

A mendoni se dialogu Kosovë-Serbi duhet të vazhdojë pa përfshirjen direkte të SHBA-së në proces?

14

2

A mendoni se dialogu Kosovë-Serbi do të përmbyllet brenda 2018?

16

3

A prisni që Serbia të njohë Kosovën me përfundimin e dialogut?

18

4

A mendoni se marrëveshjet e reja me Serbinë duhet të diskutohen në Kuvend para nënshkrimit të tyre në Bruksel?

20

5

Sipas mendimit tuaj, a ka arritur dialogu i Brukselit tëpërmirësojë marrëdhëniet Kosovë-Serbi?

22

PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME

HYRJE

Hulumtimi i opinionit publik "Normalizimi i marrëdhënieve Kosovë-Serbi: Këndvështrimi i qytetarëve" është i pesti që KDI organizon për të nxjerr në pah këndvështrimin e qytetarëve rreth procesit të dialogut Kosovë-Serbi.

Dialogu Kosovë-Serbi i iniciuar më 2011, pritet të hyjë në fazën e tretë dhe finale të tij, në kuadër të së cilës pritet që palët të nënshkruajnë një marrëveshje ligjërish të obligueshme.¹ Parahyrja e kësaj faze, ashtu si dhe fazat e mëhershme të dialogut, është shoqëruar me kundërthënie të shumta, me mungesë transparence dhe qartësie.

Nuk është ende e ditur se cilat tema do të diskutohen apo nëse akterë të tjerë ndërkombëtar, përveç BE-së si ndërmjetësuese, do të përfshihen direkt në këtë proces. Cili do të jetë ekipi negociues, çfarë roli do të kenë institucionet e vendit përfshirë këtu Kuvendi dhe cili do të jetë epilogu i këtij procesi, janë çështje të cilat ende mbesin pa përgjigje.

Lidershipi kosovar ka kërkuar që ky proces të përmbyllet sa më parë ndërsa ka deklaruar që në përfundim të dialogut Serbia do të njoh shtetin e Kosovës.² Nga ana tjetër, zyrtarët e lartë shtetëror të Serbisë kanë hedhur poshtë mundësinë e njohjes së shtetit të Kosovës duke deklaruar se dialogu në mes palëve është një proces kompromisi.³ Se çfarë kompromisesh do të jetë e gatshme të bëjë pala kosovare në këtë proces, mbetet ende për tu parë.⁴

Rasti më i fundit i aktit kriminal të vrasjes së Oliver Ivanoviç, lider i iniciativës qytetare "Liria, Demokracia, Drejtësia" (SDP), në Mitrovicë të veriut rezultoi me tërheqjen e palës serbe nga bisedimet teknike në Bruksel.⁵ Kjo ngjarje vuri në pah problemet ende të shumta të shtrirjes së sovranitetit të shtetit të Kosovës në tërë territorin e saj, duke paralajmëruar gjithashtu që faza finale e dialogut do të shoqërohet nga një diplomaci e vrazhde e garës se cila palë do të përfitojë më shumë nga ky proces.

KDI në këtë sondazh trajton disa nga këto çështje nga këndvështrimi i qytetarëve duke kërkuar opinionin e tyre nëse SHBA-të duhet të jenë të përfshira direkt në këtë proces, nëse ata presin që dialogu të përmbyllet në vitin 2018 dhe të ketë njohje formale të shtetit të Kosovës nga shteti i Serbisë.

Më tej, ky sondazh vë në pah qëndrimin e qytetarëve rreth rolit që Kuvendi duhet të ketë lidhur me marrëveshjet që do të arrihen në të ardhmen dhe mbi të gjitha vlerësimin e tyre të përgjithshëm të 6 viteve dialog – nëse ky proces ka arritur vërtet të normalizojë marrëdhëniet në mes Kosovës dhe Serbisë duke i përmirësuar ato.

Në bazë të të gjeturave të hulumtimit, KDI ofron rekomandime drejtuar institucioneve të vendit për të garantuar një proces gjithëpërfshirës dhe transparent të dialogut Kosovë-Serbi.

Këto sondazhe organizohen në kuadër të misionit të KDI-së për të promovuar transparencë, llogaridhënie dhe demokraci të përgjegjshme. Ky projekt është i financuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës për forcimin e mbikëqyrjes parlamentare të ekzekutivit dhe rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në dialogun Kosovë-Serbi.

Për më shumë informacione rreth dialogut Kosovë-Serbi dhe sondazheve paraprake klikoni te www.votaim.org/Public/Dialog.

1 Në kuadër të Forumit Ekonomik Botëror në Davos të Zvicrës, Presidenti i Kosovës z. Hashim Thaçi ka deklaruar përmes një statusi në profilin e tij zyrtar në Facebook, "se Kosova mbetet e përkushtuar për procesin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe në këtë aspekt është e domosdoshme arritja e një marrëveshjeje ligjërish të obligueshme për paqe dhe normalizim." Shih deklaratën e plotë të Presidentit Thaçi në profilin e tij zyrtar në Facebook, 26 janar 2018 në, <https://www.facebook.com/HashimThaciOfficial/>

2 Në një shkrim autorial i publikuar më 17 gusht 2017, Presidenti i Kosovës z. Hashim Thaçi ka deklaruar se nënshkrimi i një Marrëveshjeje mbi Normalizimin dhe Pajtimin ndërmjet dy shteteve do të duhej të përfshijë njohjen e ndërsjellë si rrugë e vetme që t'u jepet fund të gjitha mosmarrëveshjeve njëherë e përgjithmonë. Shih shkrimin e tij "Treni i fundit për një paqe të qëndrueshme", 17 gusht 2017 në, <http://www.president-ksgov.net/sq/oped/treni-i-fundit-per-nje-paqe-te-qendrueshme>

3 Presidenti i Serbisë Aleksandar Vučić sa i përket dialogut ka deklaruar se "dikush duhet të tregojë vullnet të mirë, të kuptojë se është kompromis e jo dikush në një formë të fitojë të gjitha", Koha Net, "Vučić: Nëse dialogu zhvillohet vetëm për ta njohur Kosovën, atëherë mirupafshim", 25 janar 2018 në, <http://www.koha.net/arberi/71523/vuciq-nese-dialogu-zhvillohet-vetem-per-ta-njohur-kosoven-atehere-mirupafshim/>

4 Në shkrimin autorial, Presidenti Thaçi ndër të tjera ka deklaruar se, që të arrijmë paqen mes dy vendeve të gjithë duhet të jemi kreativë dhe të jemi të gatshëm që të bëjmë kompromise të metutjeshme. Shih shkrimin e plotë të z. Thaçi "Treni i fundit për një paqe të qëndrueshme", 17 gusht 2017 në, <http://www.president-ksgov.net/sq/oped/treni-i-fundit-per-nje-paqe-te-qendrueshme>


5 Takimi në mes të delegacionit të Kosovës dhe Serbisë i cili parashihej të mbahej më 16 janar 2018 në Bruksel u anulua pas vrasjes së Oliver Ivanoviç në Mitrovicë po atë ditë. Për më shumë shih portalin informativ Kallxo, "Vrasja e Ivanoviçit, Anulohet Takimi i Dialogut Kosovë-Serbi në Bruksel", 16 janar 2018 <http://kallxo.com/vrasja-e-ivanoviqit-anulohet-takimi-dialogut-kosove-serbi-ne-bruksel/>



2. METODOLOGJIA

Sondazhi është zhvilluar në nivel vendi duke përdorur metodën sistematike të rastësisë, me mostër prej 1070 të anketuarëve e dizajnuar për sigurimin e mostrës përfaqësuese, e shtresuar sipas etniciteteve:

shqiptar, serb dhe minoritete jo-serbe, shtrirja sipas vendbanimeve (ubane/rurale). Sondazhi është realizuar në periudhën kohore 12-20 dhjetor 2017. Margjina e gabimit është rreth $\pm 3\%$.



Këto sondazhe organizohen në kuadër të misionit të KDI-së për të promovuar transparencë, llogaridhënie dhe demokraci të përgjegjëshme.

PYETJET E SONDAZHIT



3. REZULTATET E HULUMTIMIT TË OPINIONIT PUBLIK

Dialogu Kosovë-Serbi i inicuar pas aprovimit të Rezolutës së OKB-së më 9 shtator 2010⁶, riktheu palët në tryezën e diskutimit për të, siç u quajt, normalizuar marrëdhëniet në mes dy vendeve.

Ky dialog shënoi procesin e parë negociues në mes palëve ku SHBA-të nuk ishin pjesë direkte e pranishme në tavolinën diskutuese. Kjo u konsiderua edhe si një strategji e kalimit të përgjegjësisë për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në rajon nga SHBA-të drejtë BE-së, që simbolikisht u shënuar edhe me vizitën e Sekretares amerikane të shtetit Hillary Clinton dhe Përfaqësueses së Lartë për Politikën e Jashtme dhe Sigurisë të BE-së Baroneshës Catherine Ashton në Kosovë më 31 tetor 2012.

Gjatë kësaj vizite sekretarja amerikane Clinton kishte deklaruar SHBA-të ishin duke bashkëpunuar ngushtë me Bashkimin Evropian dhe Përfaqësuesen e Lartë Ashton për të çuar përpara dialogun politik që kishte filluar, duke iu bërë thirrje palëve për të zbatuar marrëveshjet dhe për të vazhduar bashkëpunimin drejtë normalizimit të marrëdhënieve.⁷

Në anën tjetër, përfaqësuesja e lartë e BE-së kishte deklaruar se: "[...] ky dialog kishte të bënte me përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe se BE ishte në kontakt të ngushtë me miqtë dhe partnerët në SHBA, të cilët kishin luajtur një rol vital për të mbështetur jo vetëm Kosovën, por edhe BE-në në tërësi.⁸

Pas 6 vitesh ku BE ishte ndërmjetëse e dialogut në mes palëve dhe SHBA-të mbështetëse të fuqishme të këtij procesi, lidhshipi kosovar shprehu domosdoshmërinë e përfshirjes direkte të SHBA-ve në tryezën e diskutimit. Kjo kërkesë erdhi veçanërisht për shkak të pakënaqësive të cilat shoqëruan këtë proces si dhe në prag të fazës përmbylëse të dialogut ku pritet arritja e një marrëveshjeje të obligueshme.

6 Organizata e Kombeve të Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme, Rezoluta A/RES/64/298, e miratuar më 9 shtator 2010, në http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/RES/64/298

7 Shih deklaratën e plotë të sekretares amerikane Hillary Clinton, 31 tetor 2012 në, <https://2009-2017.state.gov/secretary/20092013clinton/rm/2012/10/199899.htm>

8 Shih deklaratën e plotë të Përfaqësueses së Lartë të BE-së, 31 tetor 2012 në, http://europa.eu/rapid/press-release_MEMO-12-824_en.htm

Ishte Presidenti i Kosovës z. Hashim Thaçi i cili pas takimit me zëvendës Presidentin e SHBA-ve z. Mike Pence më 29 shtator 2017, deklaroi se, përfshirja direkte e SHBA-së në këtë fazë përfundimtare të dialogut ishte përcaktuese për arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare, të zbatueshme për të dy palët, duke shtuar se kjo ishte mënyra e vetme për të forcuar paqen afatgjatë në rajon.^{9 dhe 10}

Ndërsa, Kryeministri i Kosovës z. Ramush Haradinaj, në takimin e dytë të Këshillit të Stabilizim Asociimit ndërmjet Kosovës dhe BE-së të mbajtur me 17 nëntor 2017 në Bruksel, deklaroi se *"Kosova është e përkushtuar që të përmbyllë të gjitha çështjet e hapura me Serbinë, përmes garantimit të dialogut nga BE dhe SHBA."*^{11 dhe 12}

Kërkesës së palës kosovare për përfshirje direkte të SHBA-ve në dialog, Presidenti Vuçiç i është kundërpërgjigjur me deklarata se nëse do të ketë përfshirje të SHBA-ve në këtë proces, atëherë do të ketë përfshirje edhe të Rusisë. Ai madje ka shtuar se nëse Kosova dëshiron në dialog dikë që e ka njohur Kosovën, Serbia kërkon dikë që nuk e ka bërë këtë, e kjo është Rusia.¹³

Në anën tjetër, BE ka deklaruar se çdo ndërrim i formatit të dialogut duhet të dakordohet në mes dy palëve, qoftë kjo për përfshirjen e akterëve të tjerë në kuadër të tij.¹⁴

9 Shih deklaratën e plotë të Presidentit Thaçi, 29 shtator 2017 në, <http://www.president-ksgov.net/sq/lajme/zevendespresidenti-amerikan-michael-pence-primar-takim-presidentin-thaci>

10 Presidenti Thaçi këtë deklaratë e ka bërë edhe në rast të tjera përfshirë dhe në diskutimin e organizuar nga KDI, më 14 shtator 2017, ku kishte deklaruar se, kishte kërkuar që në fazën përfundimtare të këtij procesi, të ketë edhe përfshirje direkte të SHBA-së dhe se do të bëjë nga kjo paqe e qëndrueshme në Ballkan ishin edhe për tërë kontinentin. Shih diskutimin me Presidentin Thaçi të organizuar nga KDI në, <http://votaima.org/Public/DialogActivity/Detail/130>

11 Shih deklaratën e plotë të Kryeministrit Haradinaj, 31 janar 2018 në, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,9,7299>

12 Në seancën e Kuvendit të datës 7 dhjetor 2017 Kryeministri Haradinaj sërisht kishte përmendur këtë çështje duke deklaruar se përfshirja e SHBA-ve është domosdoshmëri, duke konsideruar që BE ka status neutral ndaj Kosovës dhe Serbia nuk e njeh Kosovën. Shih deklaratën e Kryeministrit Haradinaj në transkriptin e seancës së Kuvendit të Kosovës, 7 dhjetor 2017, fq. 67, në http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2017_12_07_10_7114_al.pdf

13 Koha Net, "Vuçiç: Dialogu në Bruksel do të vazhdojë siç do Serbia, e jo siç donë shqiptarët e Kosovës", 26 dhjetor 2017 në, <http://www.koha.net/arberi/65774/vuciq-dialogu-ne-bruksel-do-te-vazhdoje-sic-do-serbia-e-jo-sic-done-shqiptaret-e-kosoves/>

14 Shih deklaratën e Përfaqësueses së Lartë të BE-së Federica Mogherini, 11 tetor 2017, në, https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage_mt/33753/Remarks%20by%20EU%20HR/VP%20Federica%20Mogherini%20following%20meeting%20with%20Ms%20Ana%20Barnier%2087,%20Prime%20Minister%20of%20Serbia



A mendoni se dialogu Kosovë-Serbi duhet të vazhdojë pa përfshirjen direkte të SHBA-së në proces?

Duke konsideruar deklaratat e Prishtinës zyrtare, Beogradit zyrtar dhe BE-së rreth përfshirjes direkte të SHBA-ve në dialogun Kosovë-Serbi, KDI ka kërkuar qëndrimin e qytetarëve nëse dialogu Kosovë-Serbi duhet të vazhdojë edhe nëse SHBA-të nuk përfshihen direkt në dialog. Kjo pavarësisht qëndrimit të lidershit kosovar për domosdoshmërinë e pjesëmarrjes së SHBA-ve në këtë proces.

Nga rezultatet e sondazhit del se rreth gjysma e qytetarëve të anketuar (49%) mendojnë se dialogu Kosovë-Serbi nuk duhet të vazhdojë nëse nuk do të ketë përfshirje direkte të SHBA-ve në këtë proces.

Në anën tjetër, 30% e qytetarëve janë shprehur pro vazhdimin të dialogut me Serbinë edhe nëse nuk do të ketë përfshirje direkte të SHBA-ve. Ndërsa, 21% e tyre janë shprehur se nuk e dinë nëse duhet apo jo të vazhdojë dialogu nëse SHBA-të nuk përfshihen në mënyrë direkte në këtë proces.



30%



49%



21%



Sa i përket ndarjes në baza etnike, 51% e të anketuarve shqiptarë dhe 48% e të anketuarve nga komunitetet tjera mendojnë se dialogu Kosovë-Serbi nuk duhet të vazhdojë pa përfshirje direkte të SHBA-ve, kundrejt 17% të qytetarëve të komunitetit serb që ndajnë të njëjtin mendim. Në anën tjetër, 45% e të anketuarve nga ky komunitetet mendojnë se dialogu duhet të vazhdojë edhe pa përfshirje të SHBA-ve në këtë proces, kundrejt vetëm 29% të qytetarëve shqiptarë

dhe 24% nga komunitetet tjera të cilët mendojnë të njëjtin. Ndërsa, 20% e qytetarëve të anketuar shqiptarë, 38% e atyre serb dhe 27% nga komunitetet tjera janë shprehur se nuk e dinë nëse dialogu duhet apo jo të vazhdojë pa përfshirjen direkte të SHBA-ve në këtë proces.

2

A mendoni se dialogu Kosovë-Serbi do të përmbyllet brenda 2018?

Gjatë vitit që lamë pas është diskutuar shumë rreth fazës së re dhe përmbyllëse të dialogut ku është kërkuar rumbullaksimi i shpejtë i këtij procesi me anë të një marrëveshjeje të obligueshme në mes palëve.¹⁵ Pavarësisht faktit që pala kosovare ende nuk ka dalë me një strategji shtetërore rreth së ardhmes së këtij procesi dhe një numri të madh të marrëveshjeve që ende janë të pazbatuara, viti 2018 është konsideruar jo rrallë herë si afat kur do ti vijë fundi këtij procesi.¹⁶

KDI ka kërkuar nga qytetarët nëse ata vlerësojnë që procesi i dialogut me Serbinë do të përmbyllet gjatë vitit 2018 dhe ka marrë përgjigjet si në vijim:

Rreth 51% e të anketuarve nuk presin që procesi i dialogut me Serbinë të përmbyllet gjatë vitit 2018, me vetëm 22% të tyre të cilët mendojnë se ky proces do të përmbyllet. Në anën tjetër 27% e të anketuarve janë shprehur se nuk e dinë nëse dialogu do të përmbyllet apo jo gjatë këtij viti.

¹⁵ Deklarata e Presidentit Thaçi e përmendur më lartë e publikuar në profilin e tij zyrtar në Facebook, 26 janar 2018, në kuadër të Forumit Ekonomik Botëror në Davos të Zvicrës në, <https://www.facebook.com/HashimThaciOfficial/>

¹⁶ Shih deklaratën e Kryeministrit të Kosovës z. Ramush Haradinaj në Zëri "Dialogu Kosovë-Serbi në fazën përfundimtare", 26 nëntor 2017, <http://zeri.info/aktuale/173822/dialogu-kosove-serbi-ne-fazen-perfundimtare/>



22%



51%



27%



Sa i përket qëndrimit të qytetarëve në bazë të përkatësive etnike, përgjigjet në pyetjen në fjalë kanë qenë pothuajse të përafërta nga të anketuarit e të gjitha komuniteteve. Kështu, rreth gjysma e qytetarëve të të gjitha komuniteteve përkatësisht, 51% e të anketuarve shqiptarë, 46% e të anketuarve të komunitetit serb dhe 45% e të anketuarve nga komunitetet tjera, nuk presin që dialogu Kosovë – Serbi do të përmbyllet në vitin 2018. Në anën tjetër, vetëm 23% e të anketuarve shqiptarë, 19% e serbëve dhe 14% nga komunitetet tjera

mendojnë se dialogu do të përmbyllet në këtë periudhë. Ndërsa, 26% e shqiptarëve, 35% e serbëve dhe 41% e komuniteteve tjera janë përgjigjur se nuk e dinë nëse procesi i dialogut do të përmbyllet apo jo.

3

A prisni që Serbia të njohë Kosovën me përfundimin e dialogut?

Pavarësisht gatishmërisë së shprehur të palëve për të dialoguar dhe për të arritur një marrëveshje përfundimtare, pritshmëritë e tyre rreth epilogut të këtij procesi ndryshojnë rrënjësisht. Gjatë vitit të kaluar Presidenti Vuçiç në një shkrim autorial kishte deklaruar se kishte ardhur koha për tu përballur me çështjen e Kosovës dhe kishte deklaruar mes tjerash se dialogu duhet të vazhdojë, në të kundërtën do ta konservojmë konfliktin.¹⁷ Por, me 25 janar, 2018, ai ka deklaruar se *"nëse dikush mendon se ideja e procesit të normalizimit të marrëdhënieve të Beogradit e Prishtinës po zhvillohet vetëm që Serbia të detyrohet ta njohë Kosovën, dhe kjo është e tëra, atëherë faleminderit, mirupafshim"*.¹⁸ Vuçiç ka inicuar në Serbi edhe një dialog të brendshëm siç ka thënë ai për zgjidhjen e

çështjes së Kosovës, ku bën pjesë Qeveria serbe, shoqëria civile, partitë politike, Akademia e Arteve dhe Shkencave dhe Kisha.

Ndërsa nga ana tjetër Presidenti i Republikës së Kosovës z. Hashim Thaçi në një shkrim autorial të datës 17 gusht 2017, ndër të tjera ka deklaruar se *"besojmë se rrugëdalja do të ishte nënshkrimi i një Marrëveshjeje mbi Normalizimin dhe Pajtimin ndërmjet dy shteteve tona dhe se marrëveshja historike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të duhej të përfshijë njohjen e ndërsjellë si rrugë e vetme që t'u jepet fund të gjitha mosmarrëveshjeve njëherë e përgjithmonë"*.¹⁹ Qëndrim të ngjashëm kanë ndarë dhe Kryeministri i Kosovës i cili në një seancë të Kuvendit ka deklaruar se *"nuk ka arsye dhe logjikë që të vazhdojë një dialog që s'i jep fund njohjes së ndërsjellë me Serbinë"*.²⁰ Edhe Kryetari i Kuvendit z.

17 Shih deklaratën e Presidentit të Serbisë Aleksandar Vuçiç në Koha Net "Vuçiç për Kosovën: Të jemi realë, mos të fshehim kokën si struci", 24 korrik 2017 në, <http://www.koha.net/arberi/33635/vuciq-per-kosoven-te-jemi-reale-mos-te-fshehim-koken-si-struci/>

18 Shih deklaratën e Presidentit të Serbisë Aleksandar Vuçiç në Koha Net "Vuçiç: Nëse dialogu zhvillohet vetëm për ta njohur Kosovën, atëherë mirupafshim" 24 korrik 2017 në, <http://www.koha.net/arberi/71523/vuciq-nese-dialogu-zhvillohet-vetem-per-ta-njohur-kosoven-atehere-mirupafshim/>


19 Shih shkrimin autorial të Presidentit Thaçi "Treni i fundit për një paqe të qëndrueshme", 17 gusht 2017 në, <http://www.president-ksgov.net/sq/oped/treni-i-fundit-per-nje-paqe-te-qendrueshme>

20 Shih deklaratën e Kryeministrit Haradinaj në seancën e Kuvendit të datës 17 dhjetor 2017, fq 41, në <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/>



31%

Te ndare
ne baze te
perkatesive
etnike:




48%

Te ndare
ne baze te
perkatesive
etnike:



21%

Te ndare
ne baze te
perkatesive
etnike:



Kadri Veseli ka deklaruar se njohja reciproke me Serbinë është e pashmangshme.²¹ Qëndrimi rreth njohjes së Kosovës nga Serbia mund të thuhet që ndahet nga i gjithë spektri politik.

Paqartësisë rreth epilogut të këtij procesi i kanë kontribuar edhe deklaratat e zyrtarëve të ndryshëm ndërkombëtar të cilat kanë pasur qëndrime të ndryshme nëse Serbia do ta njoh Kosovën në përfundim të këtij procesi, ndërsa zyra e përfaqësueses së lartë të BE-së ose BE nuk kanë artikuluar një qëndrim të qartë përveç kërkesës për të ashtuquajturin 'normalizim gjithëpërfshirës' e cila është e paraparë edhe në kapitullin 35 të negociatave të Serbisë me BE-në.²² Në një intervistë përfaqësuesja e zyrës së BE-së në Kosovë kur është pyetur nëse do të ketë të ardhme për Kosovën dhe Serbinë pa e njohur njëra tjetrën, ajo është përgjigjur se BE ka një parim bazë, i cili është marrëdhëniet e mira fqinjësore.²³

²¹ trans_s_2017_12_14_10_7135_al.pdf

²² Shih deklaratën e Kryetarit të Kuvendit të Kosovës z. Kadri Veseli në Lajmet e Kuvendit të Kosovës, 14 nëntor 2017, në <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,128,9130>

²³ Shih dokumentin e BE-së të publikuar më 30 nëntor 2015 në <http://data.consilium.europa.eu/doc/document/AD-12-2015-INIT/en/pdf>

²⁴ Shih intervistën e përfaqësueses së BE-së në Kosovë znj. Nataliya Apostolova, 22 shtator

Lidhur me këtë çështje KDI ka kërkuar këndvështrimin e opinionit publik ku del në pah se rreth gjysma e qytetarëve të anketuar (48%) janë përgjigjur se nuk presin njohje nga Serbia në përfundim të këtij procesi, kundrejt 31% të qytetarëve të cilët presin që Serbia në përfundim të dialogut do t'a njoh Kosovën. Ndërsa, 21% e qytetarëve nuk e dinë nëse kjo do të ndodhë apo jo.

Rezultatet e sondazhit në baza etnike kanë nxjerrë në pah një përqindje të lartë nga qytetarët e anketuar të komunitetit serb, 68% e të cilëve janë shprehur se nuk presin që Serbia do ta njoh Kosovën në përfundim të dialogut. Kundrejt 47% të qytetarëve shqiptarë dhe 38% të qytetarëve nga komunitetet tjera të cilët poashtu nuk presin që kjo të ndodhë. Në anën tjetër, vetëm 1% e të anketuarve serb presin që Serbia do t'a njoh Kosovën në përfundim të këtij procesi, kundrejt 33% të shqiptarëve dhe 23% nga komunitetet tjera, të cilët presin një gjë të tillë. Ndërsa, 20% e qytetarëve shqiptarë, 31% e atyre serb dhe 39% e qytetarëve nga komunitetet tjera janë shprehur se nuk e dinë nëse do të ketë njohje të Kosovës nga Serbia në përfundim të dialogut.

2017 në, https://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/32628/interview-nataliya-apostolova-zeri-newspaper_sq



A mendoni se marrëveshjet e reja me Serbinë duhet të diskutohen në Kuvend para nënshkrimit të tyre në Bruksel?

Kuvendi i Kosovës me anë të Rezolutave²⁴ dhe ²⁶ ka autorizuar Qeverinë e Kosovës të negociojë në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi duke i kërkuar kësaj të fundit dhe ekipit negocues të raportojnë në mënyrë të rregulltë rreth këtij procesi. Për më tepër këto Rezoluta parashohin edhe përfshirjen direkte të komisioneve parlamentare përkatëse në kuadër të diskutimeve të dialogut.

24 Kuvendi i Republikës së Kosovës, "Rezolutë për dialogun midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë", e miratuar më 10 mars, 2011 në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rezoluta_per_dialogun_midis_R_Kosoves_dhe_R_Serbise_2.pdf

25 Kuvendi i Republikës së Kosovës, Rezoluta "Për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë", e miratuar më 18 tetor 2012 në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rezolute_Marredhenive_Kosova_Serbia.pdf

26 Kuvendi i Republikës së Kosovës, Rezoluta "Për dhënien e pëlqimit për nënshkrim të Marrëveshjes së Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë", e miratuar më 21 prill, 2013 në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rezoluta_per_marreveshje.pdf

Pavarësisht faktit që Rezolutat nuk janë akte ligjorisht të obligueshme, ato gjithsesi shprehin vullnetin e të zgjedhurëve të popullit andaj dhe duhet të respektohen. Në realitet Rezolutat në përgjithësi dhe në veçanti ato që ndërlidhen me çështjen e dialogut nuk kanë gjetur zbatim.

Niveli i transparencës rreth procesit të dialogut ka qenë i ulët, kjo mbështetur qoftë në deklaratat e shumta të deputetëve të Kuvendit të Kosovës ashtu dhe në analizat e opinionit publik të organizuara nga KDI.²⁷ Rëndësia e përfshirjes së Kuvendit në këtë proces është cilësuar si tejet e rëndësishme, qoftë në deklaratimet individuale të deputetëve të cilat kanë kërkuar që marrëveshjet të diskutohen në Kuvend, ashtu edhe në takimet në mes komisioneve parlamentare në të cilën u

27 KDI ka organizuar 4 sondazhe rreth dialogut Kosovë- Serbi. Rezultatet mund ti gjeni në uebfaqen Vota Ime në, <http://votaim.org/Public/Article?PollDialog=true&PollDialog=false&SelectedTab=Polls&PollSelected-MonthID=&PollSelectedYear=#polls>



propozua nevoja e një Rezolute të re rreth një roli më aktiv të Kuvendit në këtë proces.²⁸ Mbetet për tu parë se si do të zhvillohet ky proces më tej dhe cili do të jetë roli i Kuvendit në procesin e dialogut.

KDI ka pyetur qytetarët se a mendojnë ata se marrëveshjet e reja me Serbinë duhet të diskutohen në Kuvend para nënshkrimit të tyre në Bruksel.

Nga të gjeturat e këtij hulumtimit rezulton se një përqindje shumë e lartë e qytetarëve, përkatesisht 67% e tyre, mendojnë se marrëveshjet e reja me Serbinë duhet të diskutohen në Kuvend para nënshkrimit të tyre në Bruksel. Vetëm 14% e qytetarëve e mendojnë të kundërtën, me 18% të tyre të cilët nuk e dinë nëse kjo duhet të ndodhë apo jo.

Sa i përket opinionëve rreth kësaj pyetjeje në bazë të përkatesive etnike, 71% e të anketuarve shqiptarë janë shprehur pro diskutimit në Kuvend të marrëveshjeve të reja me Serbinë para nënshkrimit të tyre në Bruksel. Në përqindje të lartë këtë mendim kanë shprehur edhe qytetarët nga komunitetet tjera, 56% e tyre kundrejt vetëm 20% të qytetarëve serb të anketuar që ndajnë të njëjtin mendim. Në anën tjetër, se marrëveshjet e reja nuk duhet të diskutohen në Kuvend para nënshkrimit, janë shprehur 13% e qytetarëve shqiptarë, 31% e qytetarëve serb dhe 15% e qytetarëve nga komunitetet tjera. Ndërsa, 16% e qytetarëve të anketuar shqiptarë, 49% e atyre serb dhe 29% nga komunitetet tjera janë përgjigjur se nuk e dinë nëse marrëveshjet e reja me Serbinë duhet të diskutohen apo jo para nënshkrimit të tyre në Bruksel.

²⁸ Shih deklaratat e deputetëve në dy mbledhje të Komisioneve parlamentare të organizuara nga KDI gjatë vitit 2017 në, <http://votaime.org/Public/DialogActivity/Detail/147> dhe <http://votaime.org/Public/DialogActivity/Detail/125>



Sipas mendimit tuaj, a ka arritur dialogu i Brukselit të përmirësoj marrëdhëniet Kosovë-Serbi?

Në thelb të gjithë këtij procesi është synuar normalizimi i marrëdhënieve në mes palëve, duke përmirësuar jetën e qytetarëve të të dyja vendeve dhe rrugëtimin e tyre drejt Bashkimit Evropian.

Marrëveshja e parë e parimeve për normalizimin e marrëdhënieve e cila u ratifikua në Kuvendin e Kosovës më 19 prill 2013, u cilësua si historike nga pala kosovare²⁹ dhe ajo e BE-së³⁰ drejtë ndërtimit të raporteve të mira në mes dy shteteve.

Pavarësisht arritjes së kësaj marrëveshjeje dhe një sërë marrëveshjesh të tjera, marrëdhëniet mes dy shteteve janë përcjel-

lur me incidente të shumta disa prej tyre edhe kritike, siç ishte nisja e trenit nga Serbia në Kosovë me elemente provokative³¹, ndërtimi i murit në Urën e Mitrovicës³², arrestimi i zyrtarëve shtetëror të Kosovës nga ana e Serbisë³³, ndalimi i tyre si rezultat i fletëarresteve të kësaj të fundit³⁴ dhe së fundi edhe akti kriminal i vrasjes së Oliver Ivanoviqit që u përdor si argument nga pala e Serbisë për tu tërhequr nga takimi i dialogut teknik i paraparë të mbahej në Bruksel.³⁵

29 Në seancën e jashtëzakonshme të mbajtur më 22 prill 2013, Kryeministri i asaj kohe z. Hashim Thaçi kishte deklaruar se "jam thellësisht i bindur se kjo marrëveshje historike mes Kosovës dhe Serbisë do të reflektojë në gjithë rajonin për të mirë". Shih deklaratën e plotë të Kryeministrit Thaçi në Lajmet e Kuvendit të Kosovës, 22 prill 2013 në <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,128,5582>

30 Shih deklaratën e BE-së "Serbia dhe Kosova: marrëveshja historike hap rrugën për përparim vendimtar në perspektivat e tyre në BE" (English: Serbia and Kosovo*: historic agreement paves the way for decisive progress in their EU perspectives), në komunikatën për shtyp, 22 prill 2013 në http://europa.eu/rapid/press-release_IP-13-347_en.htm

31 Kallxo "Treni me Simbolet Serbe Mbërrin në Rashkë (Video)" 14 janar 2017, <http://kallxo.com/treni-simbolet-serbe-mberrin-ne-rashke/>

32 Koha Net, "Ndërtohet mur afër urës së Ibrit, reagon Qeveria e Kosovës", 7 dhjetor 2016, <http://archive.koha.net/?id=27&l=146134>

33 Kallxo, "Arrestohet në Serbi Drejtori i Policisë Nehat Thaçi" 29 shtator 2016, <http://kallxo.com/arrestohet-ne-serbi-drejtori-policise-nehat-thaci/>

34 Koha Net, "Ramush Haradinaj arrestohet në Francë", 4 janar 2017, <http://archive.koha.net/?id=27&l=150339>

35 Kallxo, "Vrasja e Ivanoviqit, Anulohet Takimi i Dialogut Kosovë- Serbi në Bruksel", 16 janar 2018 <http://kallxo.com/vrasja-e-ivanoviqit-anulohet-takimi-dialogut-kosove-serbi-ne-bruksel/>



27%



50%



23%



Për më shumë, shumica e marrëveshjeve të arritura që nga fillimi i procesit të dialogut në vitin 2011 ende mbeten të pazbatuara, ndërsa Serbia ende vazhdon fushatën propaganduese dhe lobuese kundër Kosovës në arenën ndërkombëtare.³⁶ Të gjitha këto zhvillime të cilat kanë dërguar mesazhe të kundërta për publikun e gjerë rreth efekteve të dialogut në mes palëve dhe ndikimin e vërtetë në përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Për të nxjerrë në pah mendimin e qytetarëve rreth kësaj, KDI ka pyetur ata se a mendojnë që dialogu i Brukselit ka arritur të përmirësojë marrëdhëniet Kosovë-Serbi, rreth të cilës ka marrë përgjigjet e mëposhtme.

Gjysma e qytetarëve të anketuar (50%) nuk mendojnë se dialogu i Brukselit ka arritur të përmirësojë marrëdhëniet Kosovë-Serbi, kundrejt vetëm 27% të tyre të cilët mendojnë se marrëdhëniet mes dy shteteve janë përmirësuar si rezultat i dialogut.

Në anën tjetër, 23% e qytetarëve janë shprehur se nuk e dinë nëse dialogu i Brukselit ka arritur të përmirësojë marrëdhëniet mes dy shteteve.

Sa i përket opinioneve në bazë të përkatësive etnike, gjysma e qytetarëve të anketuar shqiptarë (51%) mendojnë se dialogu i Brukselit nuk ka arritur të përmirësojë marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë. Një numër i madh i qytetarëve nga komunitetet tjera (46%) ndajnë të njëjtin mendim me të fundit, përfshirë edhe 31% të qytetarëve të anketuar nga komuniteti serb që mendojnë të njëjtën gjë. Në anën tjetër, 27% të të anketuarve shqiptarë dhe atyre të komuniteteve tjera dhe 22% të serbëve mendojnë se dialogu i Brukselit ka arritur në fakt të përmirësojë marrëdhëniet mes dy shteteve. Kurse, 21% e të anketuarve shqiptarë, 47% e të anketuarve serb dhe 26% e të anketuarve nga komunitetet tjera nuk e dinë nëse dialogu ka arritur apo jo të përmirësojë marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë.

36 Zëri, "Ja se si lobon Serbia kundër Kosovës në UNESCO (Video)" 16 shtator 2017, <http://zeri.info/aktuale/162354/ja-se-si-lobon-serbia-kunder-kosoves-ne-unesco-video/>

PËRFUNDIM

Rezultatet e hulumtimit të këtij opinioni publik shpërfaqin këto të gjetura:

01 Rreth **49%** e qytetareve mendojnë se dialogu Kosovë-Serbi nuk duhet të vazhdojë pa përfshirjen direkte të SHBA-ve në këtë proces. Janë 45% e të anketuarve nga komuniteti serb që ndajnë qëndrimin se dialogu duhet të vazhdojë edhe pa përfshirje të SHBA-ve në këtë proces, kundrejt vetëm 29% të qytetarëve nga komuniteti shqiptar dhe 24% nga komunitetet e tjera të cilët mendojnë të njëjtën gjë.

02 Mbi gjysma **51%** e qytetarëve të anketuar nuk presin që procesi i dialogut me Serbinë të përmbyllet gjatë vitit 2018. Qëndrim të ngjashëm ndajnë të gjithë qytetarët pavarësisht përkatësisë së tyre etnike.

03 Rreth gjysma e qytetarëve të anketuar (**48%**) janë përgjigjur se nuk presin njohje nga Serbia në përfundim të procesit të dialogut. Vetëm 1% e qytetarëve të komunitetit serb presin që Serbia do të njoh shtetin e Kosovës në përfundim të këtij procesi, krahasuar me 34% të qytetarëve të komunitetit shqiptar dhe 23% e qytetarëve të komuniteteve të tjera.

04 Një perqindje shumë e lartë e qytetarëve, përkatësisht **67%** e tyre, mendojnë se marrëveshjet e reja me Serbinë duhet të diskutohen në Kuvend para nënshkrimit të tyre në Bruksel. Ndërsa janë 71% e komunitetit shqiptar dhe 56% e komuniteteve të tjera që ndajnë këtë qëndrim, vetëm 20% e komunitetit serb vlerësojnë që Kuvendi duhet të luaj këtë rol.

05 Janë **50%** e qytetarëve që mendojnë se dialogu i Brukselit nuk ka arritur të përmirësoj marrëdhëniet Kosovë-Serbi. Këtë qëndrim ndajnë pjesa më e madhe e qytetarëve nga komuniteti shqiptar dhe komunitetet e tjera, qytetarët e komunitetit serb përkatësisht 47% e tyre nuk e dijnë se çfarë pasojash ka pasur dialogu në marrëdhëniet në mes dy shteteve



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA